



Departamenti për Monitorim

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujor - Gusht 2008

Numri i vogël i personelit në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut dhe pasiguria lidhur me vendosjen e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit shkaktojnë vonesa të panevojshme në procedurat penale dhe ndikojnë në të drejtat e të pandehurve për liri dhe për gjykim brenda kohës së arsyeshme

Misioni i OSBE-së në Kosovë është i brengosur se numri i vogël i personelit në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, dhe pasiguria lidhur me vendosjen e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), ka rezultuar në vonesa të konsiderueshme në procedurat penale. Kjo ka ndikim negativ në të drejtat e të pandehurve për gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe për liri për të pandehurit që ndodhen në paraburgim.

1. Sfond

Sipas Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2000/64,¹ “[p]ër qëllim që të sigurohet pavarësi dhe paanshmëri e gjyqësorit dhe për administrim të duhur të drejtësisë” prokurori, i akuzuari ose avokati mbrojtës mund të kërkojnë nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut që të angazhoj prokurorë ose gjyqtarë ndërkombëtar ose ndërrim të lokacionit në procedurat penale. Andaj, shumë raste serioze penale, përfshirë këtu ato që kanë të bëjnë me pretendime për krime lufte ose dhunë ndëretnike, përfshijnë prokurorë dhe gjyqtarë ndërkombëtar. Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut aktualisht është duke i trajtuar 82 raste ku përshihen 198 të pandehur në të cilat është ngritur aktakuzë.²

Ishte pritur se pas datës 15 qershor 2008, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut do t’i transferonte gradualisht kompetencat e veta tek një institucion tjetër.³ Në drejtim të këtij zhvillimi, me 21 prill 2008, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut dërgoi një “e-mail” të brendshëm me titull “Sqarim lidhur me Procedim dhe Trajtim të Rasteve”, me të cilin udhëzonte gjyqtarët të “vazhdojnë t’i procedojnë rastet dhe t’i caktojnë gjyqtarët për hapin e ardhshëm të procedurës në rastet e reja dhe ato që janë në pritje për aq kohë sa procedurat gjyqësore d.m.th. konfirmimi i aktakuzës, aktgjykimi, etj., të mund të përfundojnë jo më vonë se me 14 qershor 2008.”⁴

Tani pritet se me “ri-konfigurimin” e UNMIK-ut,⁵ Departamenti i Drejtësisë do t’i bart disa kompetenca, përfshirë këtu edhe autoritetin ekzekutiv në rastet penale,⁶ në EULEX.⁷ Edhe pse UNMIK ka mbajtur “diskutime [me EULEX-in] për bashkëpunim

¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64, *Mbi caktimin e Gjyqtarëve-Prokurorëve Ndërkombëtarë dhe Ndërrimin e vendit të tyre*, e ndryshuara përmes Rregulloreve 2001/34, 2005/50, 2006/60 dhe 2007/21.

² Raporti i DD-së mbi Transferimin e Rasteve Nr. 15, 31 korrik 2008. Këta numra nuk pasqyrojnë rastet në fazën para gjykimit.

³ Fillimisht, ishte pritur që EULEX do t’i pranonte shumicën e kompetencave të UNMIK-ut. Megjithatë, deri më sot kjo nuk ka ndodhur.

⁴ “E-mail” i brendshëm i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut i datës 21 prill 2008.

⁵ Shih Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2008/354, i datës 12 qershor 2008, paragrafi 19.

⁶ Shih Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP, *Mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVO*, 4 shkurt 2008.

⁷ Në raportin e tij më të fundit pranë Këshillit të Sigurimit, Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve theksoi se pasi që “UNMIK-u nuk mund të funksionoj me aq efikasitet si në të kaluarën, në shumicën dërmuese të detyrave të veta” duhet “t’i lejoj Bashkimit Evropian të merr rol të shtuar në sektorin e sundimit të ligjit” (Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2008/458, 15 korrik 2008, paragrafi 3).

të ardhshëm”, dy palët ende nuk kanë arritur marrëveshje mbi bartjen e kompetencave lidhur me procedurat që janë duke vazhduar.⁸ Veç kësaj gjyqtarët e EULEX-it nuk mund të pranojnë ende kompetenca për raste penale, pasi që ata nuk janë “zgjedhur dhe caktuar nga autoriteti kompetent”, siç kërkohet me ligjin me të cilin përcaktohet juridiksioni i prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it.⁹

Megjithatë, gjatë përgatitjes për transferim të ardhshëm, gjyqtarët ndërkombëtar kanë marr udhëzime për të dëgjuar vetëm ato procedura që do të mund të përfundonin në tetor 2008. Rastet e reja ose ato që do të merrnin shumë kohë do t'i lihen për trajtim EULEX-it.¹⁰

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut ka vazhduar t'i zvogëlojë nivelet në personel dhe kjo ka pasur ndikim negativ në aftësinë e gjyqtarëve për t'i proceduar rastet. Sipas Raportit më të fundit të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut mbi Transferimin e Rasteve¹¹, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut aktualisht ka nëntë prokurorë ndërkombëtar (përfshirë këtu edhe Ushtruesin e Detyrës të Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë) dhe 11 gjyqtarë ndërkombëtarë. Megjithatë, tre gjyqtarë janë larguar në gusht të 2008-ës, dhe tre gjyqtarë janë caktuar të punojnë në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Andaj, që nga shtatori i 2008, do të jenë vetëm pesë gjyqtarë ndërkombëtar që do të trajtojnë rastet penale që i janë caktuar Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut. Afërsisht para një viti, (korrik 2007), Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut punësoi 13 prokurorë ndërkombëtarë dhe 16 gjyqtarë ndërkombëtarë.

2. Shqetësime për të drejtat e njeriut

OSBE është e brengosur se dështimi për të caktuar raste dhe mungesa e personelit ka dërguar në vonesa që kanë mundur të parandalohen në gjykime penale të trajtuara nga gjyqtarë ndërkombëtarë, dhe mund të shkelin të drejtat e të pandehurve që ndodhen në paraburgim. Reduktimet në punësimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit ndihmës gjithashtu kanë zvogëluar shpejtësinë me të cilën gjykatat mund t'i trajtojnë rastet.

a. E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme

Sipas standardeve ndërkombëtare, çdo kush ka të drejtë për gjykim brenda kohës së arsyeshme.¹² Autoritetet publike kanë për detyrë të organizojnë sistemet e veta juridike në atë mënyrë që ato të punojnë në pajtueshmëri me kushtin e “kohës së arsyeshme”.¹³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur se “një ndërprerje e

⁸ Shih Procesverbalin nga Mbledhja e 5944-të e Këshillit të Sigurimit të datës 25 korrik 2008 (S/PV 5944 dhe komunikatën për shtyp SC/9407), e qasshme në, <http://www.un.org/Depts/dhl/resguide/scact2008.htm>

⁹ Ligji 03/L-053, *Mbi Juridiksionin, Zgjedhjen e Rasteve dhe Caktimi i Rasteve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë*, 13 mars 2008, Neni 1.

¹⁰ Intervistë e OSBE-së me një zyrtar nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut me 21 korrik 2008.

¹¹ Raporti i Departamentit të Drejtësisë mbi Transferimin e Rasteve Nr. 15, 31 korrik 2008.

¹² Shih Nenin 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Neni 14(3)(c), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

¹³ Shih p.sh. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Eckle kundër Gjermanisë*, 8130/78, Aktgjykim, 15 korrik 1982, paragrafi 92.

përkohshme e punës nuk përfshin përgjegjësi [...] në qoftë se [autoritetet relevante] marrin me shpejtësi të duhur, veprime ndihmëse për t'u marr me situatën e jashtëzakonshme.”¹⁴

Rastet në vijim shërbejnë si shembuj të vonesave:

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština që përshin tetë të pandehur të akuzuar për mashtrim,¹⁵ keqpërdorim të autorizimeve ekonomike,¹⁶ dhe lidhje të kontratës së rrejshme,¹⁷ gjykatësi ndërkombëtar lëshoi një vendim me të cilin konfirmonte aktakuzën e datës 8 janar 2008. Kolegji për ankesa refuzoi ankesën ndaj këtij vendimi me 14 prill 2008. Megjithatë, gjykimi ende nuk është caktuar që nga prilli 2008, përkundër afatit kohor prej një muaji të përcaktuar me ligj.¹⁸

Në një rast tjetër pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština që përfshinte akuza për larje parash,¹⁹ me 8 nëntor 2007, një gjyqtar ndërkombëtar konfirmoi aktakuzën ndaj tre të pandehurve. Me 15 janar 2008, prokurori ndërkombëtar paraqiti përgjigje ndaj ankesës kundër konfirmimit të aktakuzës. Me 14 prill 2008, kolegji për ankesa refuzoi ankesën. Megjithatë, deri në gusht 2008, shqyrtimi kryesor nuk është caktuar, përkundër afatit kohor prej një muaji të paraparë me ligj.²⁰

Kështu, që nga prilli 2008, kur ishte dërguar e-maili i brendshëm i cili kufizonte caktimin e rasteve, gjyqtarët ndërkombëtar kanë dështuar të caktojnë seanca në disa raste që bien nën juridiksion të tyre. Kjo ka rezultuar në vonesa të procedurave penale duke ndikuar kështu në të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Kjo në veçanti është brengosëse në rastet që përfshihen krime serioze dhe të pandehur ndaj të cilëve janë vendosur masa restriktive siç është paraburgimi shtëpiak ose paraburgimi.

b. E drejta për liri

Ligji i Kosovës parasheh afate kohore për paraburgim, i cili fillimisht duhet të aprovohet²¹ dhe pastaj në mënyrë periodike të rishqyrtohet nga gjykata kompetente.²² Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që të arsyetohet vazhdimësia e paraburgimit ndaj një të dyshuari, autoritetet publike jo vetëm që duhet

¹⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Milasi kundër Italisë*, 10527/83, aktgjykim, 25 qershor 1987, paragrafi 18.

¹⁵ Neni 261 (1), të Kodit të Përkohshëm Penal, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003 (Kodi i Përkohshëm Penal).

¹⁶ Id., Neni 236 (1)(2).

¹⁷ Id., Neni 237(2).

¹⁸ Neni 319(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003 (Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale). Në të kundërtën kryetari i kolegjit duhet ta njoftojë kryetarin e gjykatës i cili pastaj, nëse është e domosdoshme, do të merr hapat e duhur për të caktuar shqyrtimin kryesor. Në Raportin Javor mbi Masat Alternative/të Paraburgimit për Divizionin Ndërkombëtar për Përkrahje Gjyqësore të datës 29 korrik 2008, ky rast ishte lënë të trajtohet nga EULEX.

¹⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2, *Mbi pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale*, 5 shkurt 2004, Neni 10.

²⁰ Neni 319(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

²¹ Id., Neni 212(4).

²² Id., Neni 284 dhe në vazhdim.

të dëshmojnë se arsyet për këtë gjë vazhdojnë të ekzistojnë por gjithashtu duhet të zbatojnë “kujdes të veçantë” gjatë rrjedhës së procedurës.²³ Në të kundërtën, paraburgimi bëhet i paligjshëm²⁴ dhe personi duhet të lirohet në pritje të gjyqimit.²⁵ Këta udhëzues aplikohen jo vetëm në rastet që përfshijnë paraburgim, por gjithashtu edhe ato që përfshijnë paraburgimin shtëpiak.²⁶

OSBE është në dijeni se deri më 31 korrik (informata më e re e ofruar nga Departamenti i Drejtësisë për OSBE-në), 15 të akuzuar ndodheshin në paraburgim në lidhje me procedurat të trajtuara nga gjyqtarë ndërkombëtarë. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj të paraburgimit të prolonguar të të pandehurve pa progres në lëndët e tyre:

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština ku përfshihet një i pandehur i akuzuar për krime lufte kundër popullatës civile,²⁷ një gjyqtar ndërkombëtar konfirmoi aktakuzën me 18 janar 2008. Që nga ajo kohë, nuk ka pasur progres të mëtejshëm në rast. Shqyrtimi kryesor nuk është caktuar përkundër afatit kohor një mujor të paraparë me ligj.²⁸ I pandehuri fillimisht ishte paraburgosur me 16 gusht 2007, dhe ka qëndruar në paraburgim shtëpiak që nga 15 nëntori 2007.

Në një tjetër rast pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština, një i pandehur ndodhet në paraburgim që nga data 31 janar 2008 mbi akuza të shpërdorimit të pozitës zyrtare²⁹ dhe mashtrim në detyrë.³⁰ I pandehuri përmes një procedure tjetër është gjithashtu i akuzuar për shpërdorim.³¹ Të dy aktakuzat janë konfirmuar me 13 shkurt dhe 10 prill 2008.³² Megjithatë, që nga ajo kohë nuk ka pasur progres në këto raste. OSBE është po ashtu në dijeni se në korrik 2008 i pandehuri u hodh në grevë urie për 20 ditë, duke protestuar për vonesa të paarsyeshme në rastin e saj.

Dështimi i gjyqtarëve nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut për të caktuar seanca në rastet ku përfshihen të pandehur që ndodhen në paraburgim dështon të dëshmojë se “kujdes i veçantë” zbatohet në këto raste dhe çon në shkelje të të drejtës së të paraburgosurve për liri.

²³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Dobrev kundër Bullgarisë*, 55389/00, aktgjykim i datës 10 gusht 2006, paragrafi 79.

²⁴ Shih Nenin 5(1)(c), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

²⁵ Id., Neni 5(3).

²⁶ Shih Nenin 278(7), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Ngjashëm, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, paraburgimi shtëpiak është bars me privim nga liria, andaj çdo personi të vendosur nën paraburgimin shtëpiak i takojnë garancitë procedurale të parapara sipas Neni 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (siç është ajo që të silltet me shpejtësi para gjyqtarit për rishqyrtim të paraburgimit kundër tij/saj dhe ta ketë rastin e trajtuar me zell të veçantë ose të lirohet në pritje të gjyqimit). Shih *Vachev kundër Bullgarisë*, 42987/98, aktgjykim i 08 korrikut 2004, paragrafi 64.

²⁷ Shih Nenin 142, Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare Nr. 44 e 8 tetor 1976..

²⁸ Neni 319(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Kryetari i kolegjit përndryshe duhet të informoj kryetarin e gjykatës i cili më pas, nëse e nevojshme, do të caktoj seancën kryesore.

²⁹ Neni 339 Kodi i Përkohshëm Penal.

³⁰ Id., Neni 341.

³¹ Id., Neni 257.

³² Gjykata lëshoi një vendim me të cilin konfirmonte aktakuzën e dytë me 24 prill 2008.

c. Rekomandime

Për atë që u tha më lartë, pozicioni i OSBE-së është se:

- Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm duhet të sigurojë që, përderisa UNMIK t'i ketë kompetencat ekzekutive për rastet penale, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut të jetë i pajisur me numër adekuat të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe personel ndihmës.
- Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut duhet të dëgjojë rastet ku përfshihen të pandehur në paraburgim si çështje prioritare dhe të sigurojë që rastet penale të mos vonohen pa nevojë.